



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 365/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha Kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Ismajl Sadiku Kryesues i Vendvotimit, në Vushtrri, paraqitur kundër Kryesuesit të Vendvotimi, për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pasafatshme ankesa e parashtruar nga Ismajl Sadiku Kryesues i Vendvotimit në Vushtrri.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 17.06.2014, nga Ismajl Sadiku Kryesues i Vendvotimit në Vushtrri, e cila është dërguar me postë me datë: 11.06.2014, po nga i njëjti. Pretenduesi i ankesës kërkon të hapet kutia e votave me Nr.2704b/08R, si dhe të verifikohen fletëvotimet e subjektit politik të PDK-së, për arsyeje se janë humbur votat e kandidatit me nr.29, ku gjatë numërimit të votave ka mundur të lëshohen gabime pasi pretendohet se ka pasur vota me shumë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmerinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pas afatshme

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa është e pas afatshme sepse afati për të parashtruar ankesë në PZAP, për të gjitha parregullsitë që lidhen me ditën e votimit është definuar me nenin 119.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: " *Personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelje ligjore për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit*". Ndërsa ankesa në fjalë është parashtruar në PZAP, me datë: 11.06.2014 që nënkupton se pala ankuese ankesën e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar sipas dispozitës së sipërshënuar, andaj duke u bazuar në nenin 118.1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 365/2014 më datën 18.06.2014



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.